

# Dokument me politika: Veting në Arsimin e Lartë

**BOTUES:**

Forumi për Ndryshime në Arsim  
Rr.Illindenska numër.87/13, Tetovë, Maqedonia e Veriut.  
Fech.mk@gmail.com

**AUTOR:**

Blendi Hodai  
(Drejtor i përgjithshëm i FNA-së)

**DIZAJN:**

Rina Abdullai

**VITI I BOTIMIT:**

Tetor 2023

# DOKUMENT POLITIKASH:

## Inkuadrimi i procesit të vetingut në arsimin e lartë

Arsimi i lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut në dhjetë vitet e fundit karakterizohet me cilësi dhe transparencë të ulët. Kjo ka ndikuar që në çdo vit akademik, numri i studentëve të regjistruar në vitin e parë të ulet me nga 1000 student më pak, dhe të rritet numri i atyre që vazhdojnë studimet jashtë vendit. Sistemi arsimor është në gjendje emergjence dhe krize, andaj shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme nga Kuvendi i RMV-së do të ishte hapi parë për transformimin e tërësishëm të këtij sistemi të harxhuar që nuk prodhon cilësi.

Andaj, ky dokument me politika avokon për zgjerim të **procesit të verifikimit (vetingut) në institucionet e arsimit të lartë**, duke synuar konkretisht tri fusha kryesore: profesorë në pozita udhëheqëse, anëtarë të Bordit për akreditim dhe avancimin kriterëve për thirrjet akademike. Me zbatimin e procedurave rigoroze për verifikim në këto fusha, universitetet mund ta përmirësojnë llogaridhënien, të luftojnë korrupsionin dhe të sigurojnë integritet të thirrjeve akademike.

### Çfarë do të thotë vetingu në arsimin e lartë?

Burime të ndryshme përkufizojnë vetingun si proces të vlerësimit ose verifikimit të personit ose gjësë për përshtatshmëri, saktësi ose vlefshmëri<sup>1</sup>.

Procesi i vetingut në arsimin e lartë ka të bëjë me procedurë sistematike dhe gjithëpërfshirëse e zbatuar për evaluim, vlerësim dhe verifikim të aspekteve të ndryshme të individëve, programeve ose njësive në fushën akademike. Ky proces ka për qëllim të sigurojë cilësi, besueshmëri dhe integritet në arsimin e lartë, veprimtarinë hulumtuese dhe vendimet administrative. Përmes procesit të verifikimit (vetingut), institucionet e arsimit të lartë saktësisht shqyrtojnë dhe vërtetojnë kualifikimet, ingerencat dhe përshtatshmërinë e anëtarëve të fakultetit, administratorëve dhe personave që kanë pozita udhëheqëse në universitet/fakultet. Për më tepër, procesi shtrihet në akreditimin e programeve akademike, verifikimin e metodologjisë së hulumtimit dhe evaluimin e përshtatshmërisë së bashkëpunimeve me vlerat dhe qëllimet institucionale.

<sup>1</sup>Përkufizimi për vetingun: <https://www.dictionary.com/browse/vetting>

Rëndësia e avancimit të procesit të verifikimit (veting) në arsimin e lartë nuk mund të nënvlerësohet. Ai shërben si themel i mirëmbajtjes së reputacionit akademik, nxitjes së kulturës së ekselencës dhe përkrahjes së besimit të palëve të interesit, përfshirë edhe studentët, fakultetin, profesorët dhe bashkësinë më të gjerë akademike. Me zbatimin e procesit të fuqishëm të vetingut, institucionet e arsimit të lartë jo vetëm që do të ruajnë integritetin e tyre, por edhe do të kontribuojnë për avancim më të madh të njohurive, shkathtësive dhe inovacioneve në shoqëri.

### 1. Profesorët universitarë që kanë pozita udhëheqëse (rektorët, prorektorët, dekanët, prodekanët)

Profesorët universitarë që kanë pozita udhëheqëse kanë ndikim të rëndësishëm në drejtimin dhe politikat e institucioneve akademike. Atyre ju është dhënë në besim autorizimi kritik për vendimmarrje, duke përfshirë zhvillimin e plan programit, shpërndarjen e burimeve (menaxhimi i mjeteve buxhetore) dhe qeverisjen akademike. Prandaj, është e një rëndësie të veçantë që të shqyrtohen të ardhurat dhe aftësitë e tyre për të siguruar që këto institucione të menaxhohen në mënyrë efikase, etike dhe me fokus në ekselencë akademike. Së pari, kjo do të mundësonte identifikimin e çfarëdo konflikti të mundshëm të interesave ose shqetësime etike që mund ta rrezikojnë bashkësinë akademike dhe përvojën e studentëve në fakultete. E dyta, do të mundësojë që individët të cilëve u është besuar udhëheqja e institucioneve tona arsimore të tregojnë standardet më të larta të kompetencës profesionale, sjelljes etike dhe dedikimit për avancim të arsimit. Ky proces do ta përforcojë besimin e publikut në institucionet tona arsimore dhe akademike.

- Si Forum për Ndryshime në Arsim, propozojmë që **Inspektorati shtetëror i arsimit** ta ketë detyrim që çdo fillim të vitit akademik (1 tetor) **të kryejë inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme** në institucionet publike, private dhe private-publike të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- **Enti shtetëror i revizionit** të kryejë inspektim financiar pas mbarimit të vitit akademik në universitete dhe njësitë akademike që të kontrollohet nëse në plotësi janë zbatuar dispozitat nga Ligji për kontabilitet për buxhete dhe shfrytëzues buxhetorë dhe nëse ka shkelje ligji dhe keqpërdorim me menaxhimin e **mjeteve buxhetore publike**.

### 2. Vetingu i Bordit për akreditim në arsimin e lartë


Është e domosdoshme që procesi i vetingut të zbatohet te të gjithë anëtarët e Bordit për akreditim për përgjegjësinë e rëndësishme të miratimit të programeve të ndryshme studentore për pranimin e studentëve. Që të parandalohet korrupsioni i mundshëm dhe ndikimi i papërshtatshëm, është me rëndësi po ashtu që të gjithë anëtarët e Bordit të Akreditimit t'i nënshtrohen një procesi rigoroz të vetingut. Ky proces duhet të përfshijë kontrole të plota të historikut (i ashtuq. background check), evaluim të etikës së tyre profesionale dhe transparencë në vendimmarrje. Me përzgjedhjen e personave

kompetentë dhe të paanshëm, mund të ruhet integriteti i procesit të akreditimit, duke siguruar miratime të drejta të programeve studimore dhe ruajtjen e besueshmërisë së institucioneve të arsimit të lartë. Bordi për akreditim duhet t'i respektojë të gjitha rregulloret (ESG regulations)<sup>2</sup> si anëtare e ENQA (European Association for Quality Assurance in Higher Education), gjegjësisht standardet për akreditim të programeve. Kualifikimet që rezultojnë nga programet duhet të specifikohen qartë dhe t'i referohen nivelit të saktë të Kornizës kombëtare të kualifikimeve për arsimin e lartë dhe rrjedhimisht Kornizës së kualifikimeve të hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Në këtë vijë, Forumi për ndryshime në arsim propozon një ndryshim në Ligjin për arsimin e lartë, ku anëtarët e bordit të akreditimit nuk duhet të jenë pjesë e asnjë strukture të universitetit (rektorat, senat).

### 3. Shqyrtim i të gjithë titujve akademik dhe avancimin e kriterëve në thirrjet akademike

Avancimet në thirrje akademike **docent, profesor inordinar dhe ordinar** e reflektojnë profesionalizmin dhe kontributin e rëndësishëm në bashkësinë akademike. Megjithatë, janë ngritur shqetësime për legjitimitetin e avancimeve të disa profesorëve dhe ekzistencën e mundshme të dokumenteve të fshehura. Procesi i vetingut duhet të zgjerohet dhe të bëhet një verifikim i plotë se si disa profesorë universitarë janë avancuar në thirrjet akademike, në çfarë kushtesh dhe kriteresh dhe nëse janë respektuar kushtet ligjore për avancim. Kjo do të duhej patjetër të përfshirte shqyrtimin e të gjitha tezave të doktoratës dhe përmbajtjen e publikimeve shkencore që është e domosdoshme për arsimin e lartë më cilësor. **Si Forum për Ndryshime në Arsim, propozojmë:**

- **Formimin e komisionit të pavarur kombëtar që do të jetë përgjegjës për verifikimin e plotë (veting) të avancimit në thirrje akademike të të gjithë profesorëve universitarë në 15 vitet e fundit.** Për më tepër, që këto rekomandime të kenë rezultat, si Forum për ndryshime në arsim, sugjerojmë të ketë plotësim të Ligjit për arsimin e lartë, neni 206, paragrafi 3. **Në nenin 206, paragrafi 3, të shtohet pikë e re**<sup>3</sup> "Inspektorati shtetëror për arsim mund të mbikëqyrë ligjshmërinë e procedurave të zgjedhjes në thirrje mësimore, mësimore-shkencore dhe bashkëpunëtoare dhe mbi plotësimin e kushteve për zgjedhjen në thirrje dhe të iniciojë procedurë para gjykatës kompetente **në afat prej 15 viteve nga dita kur është kryer zgjedhja.**"



<sup>2</sup>Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë: [https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG\\_2015.pdf](https://www.enqa.eu/wp-content/uploads/2015/11/ESG_2015.pdf)


<sup>3</sup>Pjesët e hijëzuara janë ndryshimet që propozojmë të bëhen në Ligjin për arsim të lartë

- **Komisioni i pavarur kombëtar** të krijoj kritere që do të jenë pjesë e mandatit të tyre për verifikimin e plotë të avancimeve në thirrjet akademike. Si përshembull, komisioni i pavarur kombëtar të mos bëj asnjë kompromis për profesorët që kanë kryer plagjiatë në doktoratat e tyre dhe më pas janë avancuar si profesor asistent. Si dhe për profesorët e avancuar në titujt docent, profesor inordinar dhe ordinar që nuk i përmbushin disa nga kriteret pozitive, të ju jepet afat prej 5 viteve për t'i përmbushur të njejtat kritere.

Nga ana tjetër, **transparenca e universiteteve shtetërore** në Maqedoninë e Veriut mund të përkufizohet si e **joadekuate**, në mos edhe **jo-ekzistente**, gjë që mbështetet nga fakti se universitetet në Maqedoninë e Veriut kanë një histori të gjatë të të qenit të padepërtueshëm, duke mos shfaqur aspak transparencë në sytë e publikut. Ata shpesh mbajnë larg syve të publikut dokumente kritike dhe vitale, siç janë statutet dhe evidenca financiare. Transparenca me dokumente të tilla me interes publik është kritike në demokraci. Si masë për forcimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë në Maqedoninë e Veriut, propozojmë:

- **Transmetim i drejtpërdrejt (livestreaming) i mbledhjeve të Senatit të universiteteve publike.** Kjo masë synon të zgjidhë mungesën aktuale të transparencës në funksionimin e tyre, siç është vërtetuar. Duke transmetuar drejtpërdrejt këto takime, publiku dhe palët e interesuara do të kenë qasje të drejtpërdrejtë për të **vëzhguar** në mënyrë të detajuar proceset e vendimmarrjes, duke inkurajuar hapshmërinë dhe llogaridhënien në sistemin e arsimit të lartë.
- **Publikimi i të gjithë dokumenteve të rëndësishme publike** në faqen e internetit të universiteteve që të jenë në dispozicion të të gjithë qytetarëve. Përfshirë dhe **publikimin e CV** të gjithë profesorëve të angazhuar të Universiteteve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

**Forumi për Ndryshime në Arsim** beson se këto masa do të kontribuojnë dukshëm në përpjekjet e vazhdueshme për të përmirësuar cilësinë në arsimin e lartë dhe për të inkurajuar një kulturë ekselence në institucionet tona akademike. Zgjerimi i procesit të vetingut edhe në arsimin e lartë, ku ka probleme të mëdha, përputhet me vizionin tonë të përbashkët për krijimin e një sistemi arsimor progresiv, gjithëpërfshirës dhe të avancuar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.





**FECH**

Forum for Educational Change

[www.fech.mk](http://www.fech.mk)